

“Mjedisi Sot”
Nr 2199 E Premte 21/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDI

- Malesi e madhe, arrestohet inspektori i pyjores e nje tjetër, per prerje te paligjshme te pyjeve
- Monitorimi mbi gjendjen e ujit te pijshem ne rrethe
- Adriatiku ne agoni, i nxehti po e vret
- Gjirokaster, 6 mije banore pijnë uje me fekale

NGA BOTA

- Bashkimi evropian kthen syte nga teknologjia e informacionit per te reduktuar shkarkimet nga makinat
- Polonia zgjeron rrjetin e prodhuesve te pergjegjshem

Njoftime

- Aktivitete me rastin e javes pa makina
- Seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit
- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitetet per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

MALESI E MADHE, Arrestohet inspektori i Pyjores e nje tjetër, per prerje te paligjshme te pyjeve Gazeta Shqiptare, fq. 21

Prerja e paligjshme e pyjeve dhe abuzimi me detyren, kane cuar ne pranga nje inspektor te Drejtorise se Sherbimit Pyjor ne Malesine e Madhe. Ndersa eshte kapur ne flagrance dhe nje 36-vjecar nga qyteti i Shkodres, i cili ne bashkepunim me punonjesin e Pyjores, po transportonin nje sasi te konsiderueshme lende drusore pa dokumentacionin perkates. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policise se Qarkut te Shkodres, bejne me dije se inspektori Luk Nike Qosaj, banues ne fshatin Broje te komunes se Kelmendit, dhe Arben Xhaferri nga lagjia "Ahmet Haxhia" e qytetit verior, jane arrestuar pasditen e se merkures. 43-vjecari Qosaj dhe 36-vjecari Xhaferri, jane ndaluar nga uniformat blu te Koplikut, ne vendin e quajtur "Kisha e Hotit", teksa po leviznin me nje automjet tip kamion me targa SH 7981 D, i ngarkuar me nje sasi prej 12 meter kub dru zjarri (ah). Gjate kontrollit te ushtruar ka rezultuar se lenda drusore qe po transportohej me mjetin ne pronesi te Arben Xhaferrit dhe qe kapte vleren e 360 mije lekeve, nuk ishte e shoqeruar me dokumentacionin perkates. Menjehere eshte bere sekuestrimi i kamionit dhe i mallit, ndersa u jane vene prangat dy autoreve te kriminit. Inspektori i Drejtorise se Sherbimit Pyjor, Luk Qosaj si dhe Arben Xhaferri, jane derguar ne dhomat e paraburgimit te Komisariatit te Policise se Koplikut. Qosaj akuzohet per "prerje te paligjshme te pyjeve, e kryer ne bashkepunim" si dhe "shperdorim detyre". Pritet qe Gjykata e Shkalles se Pare e Shkodres te vendose masen e sigurise ne ngarkim te dy autoreve te kriminit.

Monitorimi mbi gjendjen e ujit te pijshem ne rrethe B. Disha, gazeta Metropol

Muaji gusht eshte nje nder muajt me problematik per sa i perket ndotjes se ujit te pijshem. Kjo ndodh per shkak te ngarkeses mikrobiologjike si pasoje e amortizimit te brendshem te rrjetit. Monitorimi i permuajshem i ujit te pijshem ne te gjithë vendin me qellim marrjen e masave per parandalimin e semundjeve, eshte ne prioritet te Institutit te Shendetesise Publike (ISHP). Kjo strukture, e cila eshte ne varesi te Ministrise se Shendetesise, nga monitorimet qe ka bere per muajin gusht, ndotjen e ujit te pijshem e konsideron sporadike. Nga rezultatet qe jane paraqitur ne krahasim me muajt e tjere, vendet qe jane me nje ngarkese me te madhe se vendet e tjera per sa i perket ujit te pijshem mbetet Lushnja, Tirana, Durresi, Kucova. Ne qytetin e Tiranës jane me problematike "Bulevardi Zogu I", rr. "Budi", rr. "Shkurti". Kurse ne qytetin e Vlores jane evidentuar dy pika kyce me uje te ndotur qe i perkasin lagjes "Lirimi" dhe "Pusi i Mezinit". Por shqetesuese dhe per kete vit mbetet qyteti i Lushnjes, ku situata vazhdon te mbetet e njejte per sa i perket ndotjes se ujit te pijshem si ne muajin korrik, ku per te gjithë pikat e konstatuara i jane lene detyra perkatese Ndermarrjes se Ujesjelles Kanalizimeve. Numri i pikave te monitorimeve te ujit te pijshem percaktohet ne varesi te popullsise se nje qyteti qe furnizohet me uje te pijshem nga Ndermarrja e Ujesjellesit.

Adriatiku ne agoni, i nxehti po e vret
Gazeta Shekulli, fq. 27

Adriatiku vdes pa rrymen ujore. Studimi shqetesues per te ardhmen e detit qe lag brigjet tona Dhe ne detin Adriatik ka nje rryme te vogel, nje shirit qe transporton energji... Ate energji e cila leviz ujerat e detit, duke i ndaluar keshtu Adriatikut te transformohet ne kenete. Por ndoshta per te pershkruar kete fenomen duhet te perdorim te shkuaren: Adriatiku, kishte nje rryme ujore. Nuk eshte nje ngjarje pa rendesi. Kjo anomali, (e cila eshte regjistruar 4 vjet me pare) duhet te jete formesuar tashme. Nese ngrohja globale do beje te veten dhe ne kete rast, pasojat do te jene katastrofike. E para qe do te zhduket eshte Venecia, dhe padyshim e gjithë fauna detare. Shume qete do te shfaqej dalengadale lluca, ishujt e algave do te lulezonin dhe do te kishte gjithandej grumbuj peshqish te asfiksuar.

Alarmi per Adriatikon eshte dhene dje, ne nje konference te zhvilluar mbi ndryshimet klimatike mbajtur ne Itali. Deti yne nuk ka me dimer, temperatura nuk zbret. Problemi i temperaturave nuk eshte nje problem i lidhur vetem me ujerat ne siperfaqe, nuk po ngrohet vetem "lekura" e Adriatikut. Sipas te dhenave te bera publike, temperatura e detit deri ne 100 meter thellesi eshte tashme 2 grade mbi mesataren dimerore, 15 ne vend te 13 qe ka qene. Ne dimer te 2003, ne Gjirin e Triestes mesatarja e temperatures kaloi nga 5 ne 13 grade. Praktikisht deti nuk arrin te ftohet mjaftueshem, dhe keshtu nuk aktivizohet mekanizmi qe con ne perzierjen e shtresave te ndryshme te Adriatikut. Ujerat qendrojne shume te nxehta per te ulur temperaturen, duke i dhene jete nje rryme te ftohte drejt jugut, i cili nderton motorin e nderrimit te ketyre ujerave, dhe mund te quhet ndryshe dhe frymemarrja qe mban gjalle detin. Dhe sic ndodh gjithmone ne ekosistem: nje demtim terheq nje demtim tjetër. Mungesa ne rritje e substancave ushqyesve qe vijne nga thellesite, e shkaktuar nga bllokimi i rrymave ka shkaktuar nje lekundje te mikroalgave, baza e zinxhirit ushqyes: detit i duhet te ndryshoje dieten pasi furnizimet jane mbaruar ne menyre te papritur. Por nuk mbaron me kaq. Me pak ushqim dhe me nxehte do te thote me pak aftesi per te thithur anhidrid karboni. Domethene nje demtim tjetër, nje faktor i cili rendon pershpjtimin e ngrohjes globale, i cili eshte dhe shkaku i problemit. Llogaritet qe cdo cikël humbjesh i Adriatikut ben qe te mblidhet ne qiell anhidridi i karbonit, ne nje mase te tille, sa clirohet kur digjen 5 mije hektare pyje.

Adriatiku rrezikon te kete fundin e Detit te Zi, nje pellg i mbyllur ne nje thellesi prej 150 metrash, i cili eshte tashme i vdekur. Po zhvillohet nje proces me pasoja shume te renda. Specialistet bejne thirrje dhe mendojne qe dikujt duhet t'i shkoje ne mendje te beje shpenzime publike per te ndertuar makina gjigante, per te vene ne qarkullim ujin e Adriatikut, pasi duhet pasur parasysh qe eshte nje mjek i kualifikuar dhe i garantuar: dhe ky mjek eshte pikerisht natyra. Duhet te mbledhim gjithë aktivitetin njerezor per te ndihmuar detin. Duhet lumenj me te paster dhe me te bollshem dhe peshq "inteligjente" qe te ndihmojne procesin e riekulibrit.

Sipas eksperteve, deti Adriatik rrezikon te behet Deti i Vdekur: nje grope e mbyllur dhe pa jete, nen 150 meter thellesi.

Gjirokaster, 6 mije banore pijne uje me fekale
Top Channel

Lagjia kryesore e qytetit te Gjirokastrës, "18 Shtatori", me rreth 6 mije banore, aktualisht eshte duke u furnizuar me uje te ndotur rende me amone, per shkak te infiltrimit ne rrjetin shperndares te rrjetit te largimit te mbetjeve urbane. Situaten alarmante e pranojne edhe perfaqesuesit e Drejtorise se Shendetit Publik. Rreziku i infektimit te qytetareve ne kete zone eshte edhe me i madh, pasi jo vetem

qe aty banojne rreth 6 mije njerez, por ne kete zone jane perqendruar numri me i madh i kafeneve, restoranteve, dhe bizneseve te tjera qe kane frekuentim te larte. Prej kohesh, rrjeti i Ujesjellesit ne kete zone ka qarkulluar uje te ndotur, por shkalla e ndotjes ka qene e ulet, ndersa analizat me te fundit te kampioneve te ujit kane rezultuar me nje shkalle jashtezakonisht te madhe, qe shkon deri ne 19% ndotje me amonite.

NGA BOTA

Bashkimi Evropian kthen syte nga teknologjia e informacionit per te reduktuar shkarkimet nga makinat ENDS Europe DAILY 2388

Komisioni Evropian do te ndermarre veren e ardhshme nje plan per te rritur perdorimin e informacionit dhe teknologjive te komunikimit, me qellim qe te ndihmoje me tej reduktimin e shkarkimeve te karbonit nga transporti rrugor.

Kjo u be e ditur ne kuader te nje sere iniciativash te ndermarra per t'i bere makinat me te sigurta dhe me mjedisore. Levizja perputhet me javen evropiane te levizjes pa makina, e cila zhvillohet per te gjashtin vit rradhazi dhe tema per kete vit eshte "Rruget per njerezit".

Bazuar ne rekomandimet e grupit te punes dhe te dhenave nga aktoret e interesuar, plani do te identifikojte teknologjite me efektive ne reduktimin e shkarkimeve te transportit rrugor. Keto teknologji mund te ulin konsumimin e lendeve djegese me 3%, shprehet komisioni.

Plani do te publikohet si pjese e hartes per zgjerimin e sistemit te transportit inteligjent, i bere publik vitin e kaluar gjate rishqyrtimit te dokumentit te Bashkimit Evropian per transportin.

Per me shume informacion:

<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/07/1342&type=HTML>

POLONIA ZGJERON RRJETIN E PRODHUESVE TE PERGJEGJSHEM

ENDS Europe DAILY 2390

Prodhuesit dhe shitesit e vajit per gatim dhe broshurat e fletepalosjet informative po ndeshen me objektiva ligjore per rigjenerimin e mbetjeve, ne kuader te nje draft-ligji te shpallur per konsultim nga Ministria polake e Mjedisit.

Polonia konsumon rreth 75.000 ton broshura dhe fletepalosje cdo vit, por asnje rregullore nuk ndikon tek to dhe shume prej tyre nuk jane perdorur per riciklim, ben te ditur ministria. Sipas saj, vaji per gatim, i perdorur kryesisht nga dyqanet e ushqimit te shpejte, nuk menaxhet ne menyren e duhur. Draft-ligji percakton objektivat e riciklimit ne 48% per broshurat dhe fletepalosjet dhe ne 20% per vajin e gatimit, te dyja keto duhet te arrihen perpara vitit 2014-te. Gjithashtu, ligji specifikon gjobat mbi 13 mije euro per kompanite qe nuk rregjistrohen ne listat e firmave qe jane te detyruara te zbatojne ligjin.

Per me shume:

http://www.mos.gov.pl/2prawo/prace_legislacyjne/projekty_do_konsultacji/ustawy/2007-08-22_produkowa.pdf

Njoftime

AKTIVITETE ME RASTIN E JAVES PA MAKINA

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, ne bashkepunim me Shoqaten G&G Group, ne kuadrin e “Javes pa Makina”, organizon:

Diten e Premte, dt. 21/09/2007, ora 19.00 – 22.00, ne mjediset e jashtme te kompleksit Taiwan, shfaqjen e Dokumentareve Mjedisore

Diten e Shtune, dt. 22/09/2007, ora 10.00 ne rrugen e Durresit, para Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, Ceremonine e levizjes se lire (shetitje, ciklizem e atletike) dhe paralel me te ne Sheshin “Nene Tereza” (ekspozite mjedisore, piktura mbi mjedisin) me nxenesit e shkollave dhe grupet e interesit.

Ftohen te gjithë te interesuarit dhe dashamiresit e mjedisit te marrin pjese ne keto aktivitete.

seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Shqiperise dhe UNDP Shqiperi do te organizojne seminarin permbylles “Shqiperia – Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit” (NCSA) ne 27 Shtator, 2007, ne Hotel “Tirana International”. Seminari fillon ne oren 10:00.

Plani Strategjik i Veprimit eshte mbeshtetur ne fushat e perbashketa te tre Konventave te Rios, permes vleresimit dhe analizes se nevojave prioritare te vendit per zbatimin e Konventave Globale Mjedisore dhe pasqyron ne terma praktike aktivitetet qe duhet te ndermerren per krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe te strukturave mbeshtetese me qellim menaxhimin e koordinuar e strategjik te mjedisit ne Shqiperi. Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve do te krijojë nje mjedis lehtesues per ruajtjen e biodiversiteti unik te vendit, do te lehtesoje zbutjen e vulnerabilitetit nen kushtet e ndryshimeve klimatike si dhe do te ndihmoje ne koordinimin e masave qe duhen marre per te luftuar shkretetirizimin dhe degradimin e tokes, duke ndihmuar ne te njejten kohe zbatimin e parimeve te zhvillimit te qendrueshem.

Pjesemarresit e seminarit jane perfaqesues te Ministrive te linjes, institucioneve kerkimore dhe arsimore, eksperte kombetare, OJF, si dhe perfaqesues te institucioneve financuese.

Per me shume informacion kontaktoni:

Klodi Marika

NCSA/SLM

Manager

klodi.marika@undp.org

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditore do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>
www.mjedisisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
